



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA E QYTETIT
KORCE

K O N T R A T E


E lidhur sot ne daten 21.12.2016 midis paleve:

AUTORITETI KONTRAKTOR

Bashkia Korçe, Rruga " 28 Nentori" perfaqesuar nga Kryetari i saj Z.Sotirag Filo, i quajtur me poshte porositesi .

KONTRAKTUESI

Bashkimi i shoqerive "ERALD- G "sh.p.k NIPT K36306784K dhe "HMK Consulting" sh.p.k NIPT L57129604Q, perfaqesuar me prokure Nr 3860 Rep dhe 1325 Kol date 23.09.2016 nga shoqeria "HMK CONSULTING" sh.p.k, me adrese: Korçe, Bilisht, Lgj3, Rruga Superstrada e Devollit, Pallati 32, Hyrja 1, Ap 10, e perfaqesuar nga perfaqesuesi ligjor Z.Hekuran Hoxhalli, i mëposhtë quajtur "Mbikqyresi";



BAZA LIGJORE

1. Kontrata do të qeveriset dhe interpretohet sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë.
2. Kontrata hartohet në baze të dispozitave ligjore të parashikuara nga nenet 659 dhe në vazhdim të Kodit Civil, ligjit 9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe VKM Nr 914 dt 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",
3. Dokumentet e tenderit janë pjesë perberese e kësaj kontrate.

OBJEKTI I KONTRATES

Objekti i kontrates është: Mbikqyrje "Qendra Polifunksionale dhe e Sherbimeve"

CMIMI I KONTRATES:

Vlera totale e kontrates është: 4.200.000 (kater milion e dyqind mije)lek,pa tvsh dhe 5.040.000 (pesemilion e dyzet mije)lek,me tvsh.



AFATI

Afati është 12 muaj nga data e lidhjes së kontrates

Pavaresisht sa me sipër afati i kësaj kontrate do të shtrihet paralelisht me afatin e kontrates të sipërmarrjes me objekt Mbikqyrje "Qendra Polifunksionale dhe e Sherbimeve" duke përfshirë dhe shtyrjet e mundshme të afatit që mund të lindin gjatë zbatimit të kontrates

NEGOCIATAT DHE AMENDAMENTET

1. Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë elementi të kontratës që do të ndryshonte mjaftueshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së Kontraktuesit.
2. Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qënë me shkrim, me datë, t'i referohet shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar i Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktor.
3. Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqësues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.



DETYRIMET E MBIKQYRESIT

1. Mbikqyresi gjate gjithë veprimtarise duhet te zbatoje te gjitha dispozitat e parashikuara ne kete kontrate si dhe kerkesat e detyrimet qe rrjedhin nga

Ligji Nr 8402 date 10.09.1998 "Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve", i ndryshuar.

Udhezimi e Keshillit te Ministrave Nr.3 date 15.02.2001 "Per Mbikqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve te Ndertimit", i ndryshuar.

Udhezimi i Keshillit te Ministrave Nr. 2, date 13.05.2005 "Per zbatimin e punimeve te ndertimit"

2. Shoqeria "ERALD -G "sh.p.k dhe shoqeria "HMK CONSULTING" sh.p.k do te kryejne sherbimet ne perputhje me percaktimet e bera kontraten per bashkepunim te perkoheshem te shoqerive Nr 3859 Rep dhe Nr 1324 Kol date 23.09.2016.

3. Ne rast se Mbikqyresi deshton te kryejë sherbimet sipas percaktimeve te mesiperme porositesi ruan te drejten e nderprerjes te kontrates ne perputhje me nenin "NDERPRERJA PER MOSPLOTESIM " te kesaj kontrates.

AFATET E PAGESËS

1. Pagesa do te kryhet kur Porositesi ka marre faturen nga Mbikqyresi.

2. Pagesat do te kryhen ne llogarine e shoqerise "HMK CONSULTING "sh.p.k, në Bankën Kombëtare Tregëtare në numrin e llogarisë

**"HMK-CONSULTING" SHPK 507927099CLPRCLALLAH,
IBAN NO AL0320511571927099CLPRCLALLA**

3. Palet do te konsiderojne si dite te kryerjes se pageses, ditën kur llogaria e Porositesit do te preket per te bere kalimin e vlefes ne llogarine e Mbikqyresit.



4. Monedha ne te cilen do te kryhet pagesa e Mbikqyresit do te jete me urdher xhirimi ne lek.

5 Mbikëqyrësi i punimeve do te jete perballe investitorit teresisht teknikisht, administrativisht dhe juridikisht pergjegjes per mbikqyrjen e punimeve te realizuara sipas kesaj Kontrate. Pagesa e mbikqyresit do te kryhet ne baze te perqindjes se situacioneve qe do te paraqiten per likuidim nga ana e shoqerise zbatuese te objektit.

VONESA NË ZBATIM DHE ZGJATJA E AFATIT

1. Kontraktuesi duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.

2. Me përjashtim të rastit kur Autoriteti Kontraktues është dakord për zgjatje të afatit të kontratës, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të likuadojë dëmet për vonesën në zbatim nëse Kontraktuesi dështon në kryerjen e Shërbimeve brenda periudhës së Kontrates.



3. Autoriteti Kontraktues mund të zbresë shumën e dëmeve të likuiduara që duhet paguar nga shuma e pagesës ndaj Kontraktuesit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktues duhet t'i japi kontraktuesit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.

4. Autoriteti Kontraktues do të jetë dakort për një zgjatje të afatit në rastin e Forcës Madhore.

5. Autoriteti Kontraktues mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera nëse është në interesin publik për ta bërë këtë. Në rast se Kontraktuesi ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjehere Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkaku dhe datën e propozuar të përfundimit të Shërbimeve. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi.

6. Afati i kesaj kontrate do të shtrihet paralelisht me afatin e kontratës së lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktorit për zbatimin e objektit duke përfshirë dhe shtyrjet e mundshme të afatit që mund të lindin gjatë zbatimit të kontratës.

LIKUIDIMI I DËMEVE PËR DORËZIMIN E VONUAR

Dëmet e likuidueshme për kryerjen e vonuar të Shërbimeve do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore:

2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.


PRONA INTELEKTUALE

1. Të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë Kontrates do t'i përkasin Autoritetit Kontraktues i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.

2. Mbikqyresi pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoriteti Kontraktues të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktues.

3. Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktues nga mospërgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose kryerja e Shërbimeve sipas kontratës.

4. Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktues në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimin e kontratës ose nga përdorimi i



gjërave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoriteti Kontraktues të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

NDRYSHIMI I LIGJEVE DHE RREGULLOREVE

Nëse pas datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj, rregullore, urdhëresë, urdhër ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi, nxirret ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit, ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa Kontraktuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

FORCA MADHORE

1. Mbikqyesi nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e sigurimit të kontratës, dëmeve të likuiduara ose ndërprerjen për mosplotësim nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në zbatimin e detyrimeve të tij sipas kontratës vijnë si rezultat i ndodhjes së Forcës Madhore.

2. Për qëllimet e këtij neni "Forcë Madhore" do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të Kontraktuesit mbi fajin ose neglizhimin dhe e paparashikueshme. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk janë të limituara nga, veprimet e Porositesit, qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.

3. Nëse ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, Mbikqyesi duhet të njoftojë menjëherë Porositesin. Me përjashtim kur Porositesi jep direktiva të ndryshme, Mbikqyesi duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.


NDRYSHIMI I POROSISË

Porositesi rezervon të drejtën të porosisë Shërbime shtesë deri në një madhësi që nuk kalon 20% të çmimit total të kontratës. Çdo porosi shtesë duhet të bëhet në mënyrë konsistente me rregullat dhe procedurat e parashikuara në Ligjin mbi Prokurimin Publik.

NDËRPRERJA PËR MOSPLOTËSIM

1. Porositesi mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:

- a) Mbikqyesi dështon të kryejë Shërbimet brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,
- b) Kontraktuesi dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.



2. Porositesi duhet t'i japi Mbikqyresit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japi Mbikqyresit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime korruptive ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.

NDËRPRERJA PËR SHKAK TË FALIMENTIMIT

Porositesi mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse Mbikqyresi falimenton ose bëhet i paaftë të paguajë.

Porositesi duhet t'i japi Mbikqyresit njoftim me shkrim për ndërprerjen.

NDËRPRERJA PËR SHKAK TË INTERESIT PUBLIK

1. Porositesi mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërruar për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.

2. Porositesi duhet t'i japi Mbikqyresit lajmërim me shkrim për ndërprerjen.

3. Porositesi duhet të paguajë Mbikqyresin për të gjitha Shërbimet kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë Mbikqyresit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjeshme të Shërbimeve.. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, Mbikqyresit do t'i kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

SIGURIMI I KONTRATES

1. Sigurimi i kontrates ne shumen prej 10% te vleftes se kontrates do te ofrohet nga Kontraktuesi per te siguruar ekzekutimin e detyrimeve te tij sipas kontrates.

2. Shuma e sigurimit të kontrates duhet t'i paguhet Autoritetit Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i Kontraktuesit në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

3. Sigurimi i kontrates do t'i kthehet Kontraktuesit jo më vonë se 30 ditë pas datës së kryerjes së Shërbimeve.



TERHEQJA NGA KONTRATA

1. Seicila pale mund te terhiqet nga kontrata.

2. Kur Mbikqyresi terhiqet nga kontrata ai do te shlyeje detyrimet qe kane lindur nga realizimi i pjeshem i kontrates.

3. Porositesi mund te terhiqet nga kontrata ne rastin kur Mbikqyresi shkel ndonje dispozite te kontrates ose kur arrihet ne konkluzionin se Mbikqyresi nuk do te permbushë ne rregull detyrimet kontratore.

4. Nese Porositesi terhiqet nga kontrata Mbikqyresi do te kerkoje demshperblim vetem per pjesen e realizuar te kontrates



LAJMËRIMET

- 1.Çdo lajmërim i dhënë nga njëra palë tjetrës sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë.
- 2.Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

NDJEKJA E KONTRATES

Personi përgjegjes i cili do të ndjeke zbatimin e kontrates ne perputhje me kriteret dhe kushtet e vendosura ne te eshte Drejtori i Drejtorise te Menaxhimit te Kontratave

ZGJIDHJA E MOSMARRVESHJEVE

- 1.Porositësi dhe Mbikqyresi duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrveshje me negociata direkte.
2. Ne rast se palet nuk bien dakort atehere per sqarimin e mosmarrveshjes me mirkuptim atehere palet do t'i drejtohen Gjykates Administrative te Shkalles te Pare Korce.

Kjo kontrate quhet e vlefshme vetem pasi te jete nenshkruar nga te dyja palet.


Kjo kontrate u hartua ne 5(pese) kopje, nga te cilat nje per Dosjen e Prokurimit, nje per Drejtorine e Menaxhimit te Kontratave, nje per Drejtorine e Finances, nje per veprimet me Thesarin dhe tjetra per Mbikqyresin.


KONTRAKTUESI

Bashkimi i shoqerive "ERALD -G " sh.p.k
dhe "HMK CONSULTING"sh.p.k


perfaqesuar nga :

Administratori i shoqerise "ERALD-G"sh.p.k


GEZIM ISLAMI



Administratori i shoqerise "HMK CONSULTING"sh.p.k


HEKURAN HOXHALLI
HMK - Consulting Sh.p.k.
Konsulence/Projektim/Mbikqyrje/Kolaudim
(NUIS 157100000)

AUTORITETI KONTRAKTOR

BASHKIA KORCE

perfaqesuar nga

KRYETARI


SOTIRAO QELLO

